



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.


Rrogozhinë, më 19.09.2024

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Enjte datë 26.09.2024 ora 14:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.10, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 19.07.2024.
- 3- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare në lidhje me rehabilitimin e rezervuarit të Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e nismës së Aleancës së Grave Këshilltare, për mbështetjen financiare të projektit ‘Një rrugëtim drejt të ardhmes’.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e kërkesës së z. Xhelal Tosku për sponsorizimin e botimit të librit”.
- 9- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e fondit të akorduar për mbulimin e rritjes së nivelit të pagave”.
- 10- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të bashkisë Rrogozhinë”.
- 11- Informacion nga Drejtoria e Politikave Urbane dhe Sektorëve të saj, mbi punën e bërë për periudhën Janar-Korrik 2024.
- 12- Informacion mbi masat e marra nga Drejtoria Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes për pastrimin e kanaleve të para të dyta e të treta dhe përgatitja e tyre për dimrin.
- 13- Informacion mbi punën e bërë nga Sektori i Pyjeve dhe përmisimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

- 14- Informacion mbi punën e bërë për përgatitjen e vitit të ri shkollor nga Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë Bashkisë.
- 15- Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryeviidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Gusht 2024.
- 16- Të ndryshme.
 - *Shqyrtim i kërkesës së qytetarit z. Fahri Rexhepi për trajtimin dhe strehimin e qenve endacakë.*
 - *Shqyrtim i kërkesës së qytetarit z. Haziz Kashari për ndihmë financiare për rikuperimin e dëmit të kafshëve të ngordhura.*
 - *Të tjera.*

Shënim : Për pikat 2,3,4,7,8 shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në njoftimin paraardhës të mbledhjes së KB. Për pikën 6, P.V dhe Relacioni shpjegues është përpunuar, kurse dokumentet e tjera shoqëruese të PV janë të njëjta me materialin e vënë në dispozicion në mbledhjen paraardhëse gjithashtu shtesë vjen shkresa e AKMC me Nr.1279/3.Prot datë 12.08.2024.

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- **Njoftoj të mbliidhet ditën e Martë datë 24.09.2024 ora 10 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit,** me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla - Anëtar, Gëzime Met-hasani - Anëtare, Indrit Dedej - Anëtar.
- **Njoftoj të mbliidhet ditën e Martë datë 24.09.2024 ora 10 : 30^{oo}, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave,** me këtë përberje : Lulzim Hasa - Kryetar, Isa Halili - Zv.Kryetar, Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.
- **Njoftoj të mbliidhet ditën e Martë datë 24.09.2024 ora 11 : 00^{oo}, Komisioni i Urbanistikës, Zhvillimit Ekonomik dhe Infrastukturës,** me këtë përbërje : Shpati Kolgega - Kryetar, Saimir Cani - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Gezime Met-hasani - Anëtare, Lije Dedej - Anëtare.
- **Njoftoj të mbliidhet ditën e Martë datë 24.09.2024 ora 11 : 30^{oo}, Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit,** me këtë përbërje : Sokol Gosa - Kryetar, Erind Tosku - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Fatmira Thartori - Anëtare, Besnike Coraj - Anëtare.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

ZV. KRYETAR I KËSHILLIT
ERIND TOSKU